



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIREQENIES SOCIALE  
SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK - GJINEKOLOGJIK  
“MBRETËRESHA GERALDINE”**

**RREGULLORE**

**“PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN  
NGA HAKMARRJA NË S.U.O.GJ ”MBRETËRESHA GERALDINE” TIRANË**

Miratur me datë \_\_01\_\_ / \_\_10\_\_ / 2021

**Tiranë**

# **KREU I RREGULLA TE PËRGJITHSHME**

## **Neni 1**

### **Baza ligjore**

Rregullorja " për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja" në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë, bazohet në Ligjin nr. 60/2016. "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", urdhrave dhe udhëzimeve të nxjerra për këtë qëllim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë ILDKPKI):

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje. në zbatim të legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit; përcaktimi i mënyrës dhe procedurës së hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja si dhe përcaktimi i mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë dhe të gjitha njësitë përgjegjëse të ngritura brenda tij. sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 3**

### **Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**"Autoritet publik"** ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin përtë drejtën e informimit.

**SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë** është institucion shëndetësor publik Universitar ku harmonizohet aktiviteti diagnostik dhe mjekues me procesin pedagogjik dhe kërkimoro-shkencor. Në kuptimin e nenit 37, të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", në Tiranë është Spital Terciar. Ai është gjithashtu një qendër reference kombëtare. Ndodhet i vendosur në adresën: Bulevardi "Bulevardi Zogi i Parë", Tiranë. Spitali Uneversitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" sipas Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 10.09.2004 "Për disa ndryshime në VKM-në, Nr. 70, datë 15.02.2001, "Për statusin e Spitaleve Uneversitare" dhe sipas Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 29, datë 15.01.2001, është emërtuar 'Spitali Uneversitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë".

**"Organizatë"** është autoriteti publik në këtë rast SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë.

Neni 2, pika 1/ a e tij. parashikon se: "Çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedural administrative, organet ligjvënëse, gjiqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli. organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli. organet shtetërore dhe entet publike. të krijuara me Kushtetutë ose me ligj."

**"Njësia përgjegjëse"** është organi i posaçëm i caktuar brenda autoritetit publik, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës, i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit.

**"Sinjalizim"** është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose SUOGJ

“Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik.

“**Sinjalizues**” është individ i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

“**I sinjalizuar**” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

“**Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni**” është një veprim ose mosveprim fakte ose rrethana të kryera në një organizatë për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim sipas këtij ligji se mund të përbëjë korrupsion.

“**Mbrojtje**” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja sipas mekanizmit të përcaktuar në Kreun V të ligjit nr. 60/2016.

“**Hakmarrje**” është çdo veprim ose kërcënim i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, i kryer nga organizata me natyrë diskriminuese disiplinore ose që në një formë tjetër të padrejtë dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

## KREU II

### VEPRIMTARIA E NJËSISË PËRGJEGJËSE NË SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”

#### Neni 4

#### Parimet e veprimtarisë 1

1. Njësia Përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, bazohet në parimin e:

- ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
- njohjes së identitetit të sinjalizuesit. përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anomm;
- sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- procedures së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

2. Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016, si strukturë që ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj mban kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në.

3. Njësiti përgjegjëse në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, veprojnë në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo influence tjetër të padrejtë që mund të pengojnë realizimin e detyrave të tyre në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

#### Neni 5

#### Njësiti përgjegjëse në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë

- Njësiti përgjegjëse në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 10, pika 1. të Ligjit 60/2016 dhe VKM nr. 816, datë 16.11.2016. “Për strukturën kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësive përgjegjëse në autoritetet publike në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2. Në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë ngrihen dhe funksionojnë këto njësi përgjegjëse:
  - a) Njësia Përgjegjëse SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” për:
  - b) Zyra e Burimeve Njerëzore.
3. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse largohen nga kjo detyrë me urdhër të titullarit të autoritetit publik kur:
  - a) japin dorëheqjen me shkrim nga detyra e njesisë përgjegjëse. e cila i dërgohet, njëkohësisht. edhe ILDKPKI-së:
  - b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
  - c) kryejnë shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
  - d) përfundon marrëdhënien e punës me autoritetin publik.
4. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës ndërmjet autoritetit publik dhe punonjësit të Njesisë Përgjegjëse informohet menjëherë ILDK.PK.I-ja. Titullari i autoritetit publik merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë punonjësin e larguar të Njesisë Përgjegjëse me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

## **KREU II PROCEDURAT E VEPRIMIT**

### **Neni 6 Kryerja e veprimeve procedural**

1. Veprimet procedurale të Njesisë Përgjegjëse, kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016. këtë Rregullore dhe për aq sa nuk rregullohet në to sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimi për veprimet procedurale për të cilat Njësia Përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

### **Neni 7 Mbrojtja nga hakmarrja**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016 mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata duke përfshirë por pa u kufizuar në to si:
  - shkarkimin nga puna
  - pezullimin nga puna, ose pezullimin nga një, ose më shumë detyra;
  - transferimin brenda ose jashtë organizatës;
  - uljen në detyrë;
  - uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
  - humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
  - mosngritjen në detyrë;
  - heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
  - vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
  - forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të institucionit për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek titullari i institucionit dhe një kopje e saj i dërgohet Njesisë përgjegjëse.

Organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes brenda 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, ILDKPKI. me kërkesë të sinjalizuesit menjëherë i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për të urdhëruar autoritetin

publik të marrë të gjitha masat sipas këtij neni.

Nëse organi kompetent nuk merr masat e kërkuara ILDKPKI i drejtohet me kërkesëpadi gjykatës kompetente.

## **KREU IV HETIMI ADMINISTRATIV**

### **Neni 8 Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje**

Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek Njësia Përgjegjëse, sipas Formularit kërkesë Për Mbrojtje nga Hakmarrja.

Në rast kur në institucion nuk ka njësi përgjegjëse të caktuar, sinjalizuesi që pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje i drejtohet drejtpërdrejtë ILDKPKI-së

3. Njësia Përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI. I që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

4. Njësia Përgjegjëse brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë saj, i cili do të ndjekë çështjen. Përmbajtja e regjistrimit të posaçëm për këtë qëllim, përcaktohet me urdhër të veçantë të titullarit të institucionit sipas formatit të miratuar nga ILDKPKI.

### **Neni 9 Hetimi administrativ dhe barra e proves**

Njësia Përgjegjëse heton administrativisht pretendimet për hakmarrje, për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur është duke ndodhur ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.

Njësia Përgjegjëse gjatë hetimit administrativ, i kërkon me shkresë organit/njesisë strukturore të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Organi/njësia strukturore ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet Njesisë Përgjegjëse me shkrim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

### **Neni 10 Bashkëpunimi**

Organi/njësia strukturore dhe sinjalizuesi bashkëpunojnë me Njësinë Përgjegjëse në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Organi/njësia strukturore është e detyruar të paraqesë informacione, prova dokumente deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Njesisë Përgjegjëse.

Organi/njësia strukturore paraqet me shkrim çdo deklaram apo argument.

### **Neni 11 Mjetet e kërkimit të provës dhe sigurimi i saj**

- Gjatë hetimit administrativ Njësia Përgjegjëse me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:

të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;

të marrë dokumente dhe prova të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

të vizitohet vende të caktuara.

Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj. Njësia Përgjegjëse kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).

Njësia Përgjegjëse që zhvillon procedurën administrative, mund të vendosë sigurimin e

provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave, bie mbi Njësinë Përgjegjëse.

## **Neni 12**

### **Njoftimi i sinjalizuesit**

Njësia Përgjegjëse njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për mbrojtje për statusin e hetimit administrativ të kësaj kërkesë dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë. Pavarësisht nga afatet e njoftimit. Njësia Përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

## **KREU V MASAT DHE AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT**

### **Neni 13**

Masat në përfundim të hetimit administrativ

Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik. Njësia Përgjegjëse i drejtohet me shkrim organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për të urdhëruar autoritetin publik për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.

Njësia Përgjegjëse parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.

### **Neni 14**

#### **Afati i përfundimit të hetimit administrativ**

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

### **Neni 15**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë.

**D R E J T O R I**

**Eliona DEMALIAJ**

Përgatiti: Autoriteti Përgjegjës  
Adriana Kopani  
Anxhela Kostandini  
Suela Struga